



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. _____. 2018

PËR

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE, NUMRIT THELBËSOR DHE KËRKESËS SË MJAFTUESHME TË PERSONAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE, PËR T'U ARSIMUAR NË GJUHËN E PAKICËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13 të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat që i përkasin një pakice kombëtare, kanë të drejtë të mësojnë dhe/ose të mësohen në gjuhën pakicës në institucione arsimore të caktuara nga ministri përgjegjës për arsimin.
2. Në institucionet arsimore ekzistuese, ku gjuha e arsimimit është gjuha shqipe, nxënësit që i përkasin një pakice kombëtare kanë të drejtë arsimohen në gjuhën e pakicës që i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, sipas kurikulave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në të cilat personat që i përkasin një pakice kombëtare do t'u sigurohet e drejta për t'u arsimuar në gjuhën e pakicës, përcaktohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- a. numrit të personave që i përkasin pakicës, i cili duhet të jetë jo më pak se 20 për qind e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative;
 - b. periudhës së regjistrimit si banor në njësinë e vetëqeverisjes vendore që nga momenti i njohjes formale të pakicës, e cila lidhet me banimin tradicionalisht në këtë njësi, konfirmuar me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga Regjistrat Themeltarë të Gjendjes Civile dhe /ose Regjistri Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010.
 - c. numrit të nxënësve që i përkasin pakicës kombëtare i cili duhet të jetë jo më pak se 15 për klasë;
 - d. shprehjes së vullnetit në mënyrë formale nga prindër apo kujdestarë ligjorë të fëmijëve që i përkasin një pakice.
4. Mbi bazën e kërkesave të prindërve/kujdestarëve të fëmijëve të pakicës kombëtare në njësitë e vetëqeverisjes vendore ose njësinë administrative, me konfirmim nga prefekti, ku numri i nxënësve për klasë të pakicës kombëtare është jo më pak se 15, nxënësit mësojnë edhe në gjuhën e pakicës.
 5. Në raste të veçanta, kur numri i nxënësve të pakicës është më i vogël se 15, funksionimi i institucioneve arsimore, ku mësohet dhe gjuha e pakicës, bëhet me akt të veçantë të ministrit përgjegjës për arsimin.
 6. Institucionet arsimore në gjuhën e një pakice kombëtare, ashtu si gjithë institucionet e tjera arsimore, funksionojnë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
 7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2018

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR

**KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË VETËQEVERISJES
VENDORE, NUMRIT THELBËSOR DHE KËRKESËS SË
MJAFTUESHME TË PERSONAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE,
PËR T’U ARSIMUAR NË GJUHËN E PAKICËS”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky akt nënligjor është hartuar në kuadrin e plotësimit të paketës nënligjore në zbatim dhe bazuar në ligjin nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Ai ka për qëllim vendosjen e kritereve për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Relacion shpjegues për PVKM “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare, për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës”

Ky projektvendim hartohet në përputhje me programin e Qeverisë Shqiptare dhe në përputhje me angazhimin e saj në përmbushje të standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave kombëtare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi nxit vendosjen e kriterëve për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrin e banorëve, numrin e fëmijëve nën 16 vjeç dhe numrin e prindërve/kujdestarëve që janë pjesë e një pakice kombëtare.

Projekt-akti krijon kushte të favorshme për hapjen dhe funksionimin e institucioneve arsimore dhe klasave mësimore në gjuhën e pakicave kombëtare, në mënyrë që fëmijët/ nxënësit e pakicave kombëtare të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre kombëtare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare, për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës”, mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13, pika 3, të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit me acquis communautaire.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare”, synon të përcaktojë kriteret të qarta për përcaktimin e njësive të

Relacion shpjegues për PVKM “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare, për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës”

vetëqeverisjes vendore, numrit të formimit të klasave për nxënësit e pakicave kombëtare.

Projektvendimi përcakton të drejtën kushtetuese për të mësuar dhe, ose të mësohen në gjuhën e tyre amtare në institucione arsimore të caktuara për të studiuar historinë, traditat dhe kulturën e tyre.

Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë të drejtën e personave që i përkasin një pakice kombëtare për t'u arsimuar në gjuhën e pakicës. Në këtë kuptim njësitë e qeverisjes vendore përcaktohen si të tilla kur numri i personave që i përkasin pakicës është jo më pak se 20 për qind e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative; periudhës së regjistrimit si banor në njësinë e vetëqeverisjes vendore që nga momenti i njohjes formale të pakicës, e cila lidhet me banimin tradicionalisht në këtë njësi, konfirmuar me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga Regjistrat Themeltarë të Gjendjes Civile dhe /ose Regjistri Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010; numrit të nxënësve që i përkasin pakicës kombëtare i cili duhet të jetë jo më pak se 15 për klasë; shprehjes së vullnetit në mënyrë formale nga prindër apo kujdestarë ligjorë të fëmijëve që i përkasin një pakice.

Projektvendimi ka parashikuar se mbi bazën e kërkesave të prindërve/kujdestarëve të fëmijëve të pakicës kombëtare në njësitë e vetëqeverisjes vendore ose njësinë administrative, me konfirmimin nga prefekti, ku numri i nxënësve për klasë të pakicës kombëtare është jo më pak se 15, nxënësit mësojnë edhe në gjuhën e pakicës.

Në raste të veçanta, kur numri i fëmijëve apo i nxënësve të pakicave është më i vogël se 15, funksionimi i institucioneve arsimore, ku mësohet dhe gjuha amtare e pakicës, bëhet me akt të veçantë të ministrit përgjegjës për arsimin.

Si për të gjitha institucionet e tjera arsimore, edhe institucionet arsimore që përfshijnë gjuhën e një pakice kombëtare, Ministria përgjegjëse për arsimin ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të tyre.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Ministria e Brendshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për PVKM "Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare, për t'u arsimuar në gjuhën e pakicës"

Për hartimin e këtij projektvendimi ka kontribuar grupi i punës i ngritur në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për hartimin e akteve nën ligjore në zbatim të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektvendim është hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme. Përmes rolit koordinues të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ky projektvendim i është nënshkruar paraprakisht ekspertizës së ekspertëve të Këshillit të Evropës dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë për Pakicat Kombëtare të OSBE-së.

Projektvendimi i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk ka kosto financiare.

PROPOZUESI

MINISTRI I ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

LINDITA NIKOLLA

Lindita
Nikolla

Digitally signed by
Lindita Nikolla
Date: 2018.05.31
15:53:27 +02'00'

PROPOZUESI

MINISTRI I BRENDSHËM

FATMIR XHAFAJ

Koli
Bele

Digitally signed
by Koli Bele
Date:
2018.05.24
14:40:18 +02'00'